



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 43

Datë: 23. 10. 2020. Ora: 10:00.

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burmi Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

2. Aktivitetet e ZRPP-së:

- Njoftim për zbatimin e aktiviteteve nga Plani Operacional

3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

-Shqyrtimi i dhe miratimi i vendimit për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës,

-Shqyrtimi i dhe miratimi i Planit Operacional për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës,

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, që do të mbahen më 29 nëntor 2020,

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës,

-Shqyrtimi dhe miratimi i aktiviteteve të informimit publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicën e Veriut 29 nëntor 2020,

-Formimi i Këshillit mbikëqyrës për aktiviteteve të informimit publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicën e Veriut 29 nëntor 2020,

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë të ZRPPC për ndryshim në Planin e Punës së KQZ për 2020

4. Të ndryshme.

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Sa i përketë rendit të ditës, a ka ndokush vërejtje ?

Sami Kurteshi: I kam pa dy pika që, referojnë në dy këshilla. Është mirë që këto dy pika, të jenë një...!

Valdete Daka: Në cilin këshill ta lëmë ? atëherë, le të bartetet te KOZ-i.

2. Aktivitetet e ZRPP-së:

Njoftim për zbatimin e aktiviteteve nga Plani Operacional:

Yll Buleshka: Zyra, mbas aprovimit të planit operacional, ka ndërmarrë gjithë hapat e nevojshëm, s'i: Njoftimi i të gjitha partive nga regjistri në komunat ku organizohen zgjedhjet dhe i publikut, se është hapur afati për aplikim për certifikim të partive politike dhe kandidatëve të tyre në komunën e Mitrovicës së veriut; Zyra, operon me orar të zgjatur deri në orën 18:00; Janë shqyrtuar edhe nevojat për staf...!

Valdete Daka: Vazhdojmë...

3. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, që do të mbahen më 29 nëntor 2020:

Alim Rama: Edhe njëherë, nëse kryeshefi e ka nënshkruar aktemrimin, sepse duhet me qenë i përgjegjshëm ndaj ligjit. Nëse çdo gjë ka shkuar në rregull...

Valdete Daka: Kemi diskutuar njëherë, por besoj do të diskutojmë sërish...Ju lutem vazhdojmë...

Alim Rama: Këshilli, ka marrë rekomandimin për shkurtimin e afateve. Rekomandimi, është ndërruar me vota 4 me 1, në kundërshtim me ligjin dhe unë kam votuar kundër shkurtimit të afateve për zgjedhjet në Podujevë...Rekomandimi i Sekretariatit ka qenë që afatet të jenë të njëjta, por për Mitrovicë është shkurtuar në 15 ditë, kurse 5 ditë në Podujevë....

Unë, tha z. Rama, nuk e shoh të arsyeshme që të shkurtohen afatet... Ai, dha arsyet dhe shpjegimet e tij se, pse ka votuar kundër...

Valdete Daka: Afati kryesor i cili i intereson opinionit është afati i fushatës zgjedhore i cili, është rekomanduar të filloj me 23 nëntor, dhe të përfundoj me 27 nëntor, që i bie 5 ditë! S'i dhe afatet tjera, s'i për shembull ai për vëzhguesve shtesë dhe mediave që fillon me 25 tetor, dhe përfundon me 23 nëntor; Aplikimi për vëzhgues shtesë të subjekteve politike dhe organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve që fillon me 1 nëntor, dhe përfundon me 21 nëntor, aplikimi për regjistrim s'i votues jashtë Kosove, fillon me 30 tetor, dhe përfundon me 7 nëntor, aplikimi për votim të personave të ngjuar në shtëpi fillon me 2 nëntor, dhe përfundon me 6 nëntor, dhe afati për regjistrimin e votuesve me lëvizje të kufizuara në ndonjë institucion dhe votuesve me rrethana të veçanta fillon më 16 nëntor, dhe përfundon 19 nëntor.

Ky, është propozimi...!?

Sami Kurteshi, tha se ka votuar kundër për faktin se, nuk ka ndonjë arsye ligjore të shkurtohen afatet, dhe se në një fushatë zgjedhore edhe KQZ dhe PZAP mundën më lehtë me i përcjellë fushatat etj. Prandaj, tha ai nuk pajtohet me këtë plan...

Sami Hamiti: E kemi debatuar gjatë në KOZ, por megjithatë flasim për një fushatë më komplekse, sepse në Podujevë procesi ka shkuar deri në ditën e zgjedhjeve...pra, e para shpenzimet kanë ndodhë, dhe ne sa më pak të jemi të vëmendshëm, ne imponojmë shpenzime të reja në proces... Unë, kam gjykuar që s'duhet të mbahet fare fushatë, por 5 ditë janë të mjaftueshme.

Arianit Elshani: Vendimi në KOZ por edhe në Këshillin për Çështjet Ligjore, janë edhe mbi bazën e deklarimeve publike të anëtarëve të KQZ –së. Mirëpo, rrethanat janë të këtitilla që të kemi parasysh edhe gjendjen e pandemisë. Ka pasur fushatë në Podujevë, po thuhet edhe këtu, dhe fushata për 5 ditë mendoj që është i pranueshëm, sado që besoj se fushata në përgjithësi do të jetë e kufizuar sepse, të këtitilla janë rrethanat...

Valdete Daka: Ishte dashur që të e shpjegojmë faktin se qysh do të jetë fushata, qysh do të realizohet sepse rrethanat janë të jashtëzakonshme! Një fushatë ka përfunduar në mars, dhe ka qenë e paraparë për një listë votuese, dhe kjo ka pasur shpenzime, dhe janë bërë shpenzimet... Dhe se, zyra duhet të na japë një shpjegim se për cilët votues bëhet fushata...

Eshref Vishi: Fushata në Podujevë është specifike. Kur flasim për fushatën, nuk mund të flasim vetëm për votuesit e rinj prej marsit e këndej, mirëpo fushata bëhet për tërë elektoratin! Është specifike për

arsye se, të gjitha aktivitetet kanë përfunduar! Do të thotë, KOZ i ka përfunduar gjitha aktivitetet. Por, ka ndodhë një ndërprerje e procesit zgjedhor me 14 mars, dhe që nga atëherë ne jemi në një situatë pandemike të jashtëzakonshme. Për mendimin tim kjo fushatë nuk e ka kuptimin e kontakteve fizike dhe tubimeve me elektorat, për më tepër është fushatë virtuale r cila do të zhvillohet përmes informimit publik. Për mendimin tim, fushata prej 5 ditë është e mjaftueshme...

Në debat rreth shqyrtimit të kësaj pike, morën pjesë edhe: Alim Rama, Čemailj Kurtiši, Arianit Elshani, Yll Buleshkaj (ZRPP).

Valdete Daka: E hedh në votim rekomandimin e KOZ-it ?

Anëtarët e KOZ-së, miratuan rekomandimin e KOZ-it për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, që do të mbahen më 29 nëntor 2020: me 9 vota për, dhe 2 vota kundër (Sami Kurteshi dhe Alim Rama)

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës:

Alim Rama: Në këshill, kemi shqyrtuar edhe Planin Operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës. E keni para jush planin. Ky plan është në sinkron me afatet e aprovuara, dhe s'i rrejdhojë fushata ka me qenë 5 ditë... (ju kujtoj se unë kam votuar kundër), pastaj është lista votuese...

Anëtarët e KOZ-së, miratuan rekomandimin e KOZ-it lidhur me planin operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës: me 9 vota për, dhe 2 vota kundër (Sami Kurteshi dhe Alim Rama)

3.Shqyrtimi dhe miratimi i aktiviteteve të informimit publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicën e Veriut 29 nëntor 2020:

Alim Rama: Kemi shqyrtuar edhe aktivitetet e informimit publik për të dy komunat. Është para jush plani, dhe ai është në sinkron me planin e informimit në mars me pak ndryshime! KOZ e ka aprovuar në mënyrë unanime.

Anëtarët e KOZ-së, me vota unanime miratuan rekomandimin e KOZ-it lidhur me informimin publik, duke mos i përfshirë detajet – specifikat e realizimit të projektit.

4. Formimi i Këshillit Mbikëqyrës për aktiviteteve të informimit publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicën e Veriut 29 nëntor 2020:

Alim Rama: Formimi i këshillit mbikëqyrës, është shqyrtuar tashmë, dhe rekomandimi është që këshilli i kaluar të veprojë. Na duhet ta shtojmë një anëtarë nga komunitetet....!

Valdete Daka: Propozoj që Nenadi të jetë...!

Sami Hamiti: Kush ka qenë përbërja e kaluar...?

Burim Ahmetaj: Valmira Selmani (aktualisht, është në pushim lehonie), dhe kjo duhet zëvendësuar prandaj, propozojmë që Vesa Xharra, ta zëvendësoj.

Valdete Daka: Atëherë, me këto dy ndryshime, kush është për këtë këshill ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Këshillit Mbikëqyrës për aktivitetet të informimit publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicën e Veriut 29 nëntor 2020.

Valdete Daka: Tjetër...?

5.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë të ZRPPC për ndryshim në Planin e Punës së KQZ për 2020

Alim Rama: E kemi kërkesën e ZRPP-së, dhe këtë e kemi shqyrtuar. Edhe pse ne e rekomandojmë, ne kemi kërkuar nga ZRPP t'i ri sistemojë aktivitetet e veta. Në KOZ, në parim nuk jemi pajtuar rreth ndryshimit të rregullores sepse, ligji është në proces... Ne, në parim e kemi miratuar kërkesën, mirëpo...

Burim Ahmetaj: Ne jemi në proces, jemi në shqyrtim të gjendjes mirëpo, për shumë arsye rregullat zgjedhore dhe plani strategjik, janë të pamundura të preken. Ne, do ta vlerësojmë me përpikmëri situatën, gjendjen që e kemi para vetës, mirëpo gjykojmë që e kemi të pamundur që këtë vit të zhvillojmë të gjitha aktivitetet. Sido qoftë, ne do ta kemi vlerësimin tonë rreth asaj se çka do të mundemi, dhe se cka nuk do të mundemi të realizojmë këtë vit nga plani i punës...

Eshref Vishi: Mendoj se këto aktivitete nga ZRPP janë pjesë e planit të punës, dhe mos të vijnë këtu në mënyrë partikulare, kërkesat të mos jenë pjesë – pjesë për tërheqje të aktivitetet për shkak të procesit zgjedhor. Le të vije në takimin e radhës edhe kjo kërkesë, bashkë me kërkesat tjera dhe s'i tërësi i shohim të gjitha kërkesat...

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Alim Rama, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Sami Kurteshi, dhe Valdete Daka.

Valdete Daka: Atëherë, kush është për këtë rekomandim...?

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për, dhe 2 vota kundër anëtarët e KQZ-së miratuan këtë rekomandim.

Të ndryshme!

Arianit Elshani: Duke u mbështetur në Dekretin e Presidentit lidhur me zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicën e Veriut 29 nëntor 2020, ku në pikën 3 na udhëzon edhe ne s'i KQZ që, këto zgjedhje të jenë të organizuara konform me ligjin mbi Pandeminë, d të kërkoja nga ju kryetare dhe kryeshefin të takoheni me faktorët relevant institucional që, të kemi

një pasqyrë të qartë të organizimit tonë; Por edhe të kemi një njoftim për partitë politike se s'i kanë të drejtë ta bëjnë fushatën...

Valdete Daka: E kemi një manual, por do të kontaktojmë së paku edhe njëherë me IKPSH-në apo Ministrinë e Shëndetësisë që të na e konfirmojnë edhe njëherë këtë manual, apo me ndonjë ndryshim eventual, dhe ne qysh sot do të komunikojmë...

Sami Kurteshi: S'i kolegë, ju lutem të respektohen masat antikovid në KQZ...